

ALBAN TUFA  
**ATA ISHIN (MBETËN) DY**  
POEZI

---

BOTIMET TOENA



ALBAN TUFA

ATA ISHIN (MBETËN) DY

poezi

BOTIMET TOENA

Tiranë

Ky libër u botua me mbështetjen e Qendrës Kombëtare të Librit  
dhe Leximit, Shqipëri.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore letrare: Edona Marku

Përkujdesja grafike *dhe* kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 9789928376633

© Botimet Toena *dhe* autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë  
lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit  
të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollesha", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: [botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[toena.porosionline@gmail.com](mailto:toena.porosionline@gmail.com)

<https://toena.al>

*Prindërve të mi*



## ATA ISHIN (MBETËN) DY

Ata ishin shtatë,  
plus një, vuajtjen mes tyre,  
e cila sillej si gripi, sapo shërohej i shtati, sëmurej i pari,  
duke e kryer secili ciklin e vet.

Ata ishin shtatë,  
secili mund të mbanin nga një emër dite,  
babai nëse mund ta themi kështu ishte e diela,  
barra e madhe javës,  
nëna, pa dyshim e shtuna, që i paraprin barrës,  
dhe bëhet njësh me të, derisa harrohet që është aty  
deri javës që vjen.

Fëmijët,  
ata mund të jenë çdo ditë jave  
veç sa për t'i veçuar, siç veçohen delet në vathë,  
për të tjerët, se çobani i njeh nga forma e këmbëve.  
Ata zgjodhën vetë të ishin shtatë,  
duke pasur shumë mundësi të ishin dy.  
Imagjinojeni një javë me dy ditë, e shtunë dhe e diel,  
secila do ishte ditë e pranueshme dasme,  
ditë zyrtare pushimi,

njëkohësisht ditë morti,  
koha do hahej shpejt, një biskotë dyshe me fare pak  
çokollatë në mes,  
si fëmija mes çiftit në krevat ditët e para të jetës,  
i imët, i padukshëm, i pakrahasueshëm  
me prindërit dhe me botën,  
por mjaftueshëm i ëmbël për të ndrequr shijen e jetës.

Shtatë ishin ata,  
në shtëpinë përdhese  
në bishtin e fshatit, si dardhë.  
Vetminë mund ta mposhtësh me dy mënyra:  
të vrasësh veten ose të lindësh fëmijë,  
në të dyja rastet duhet të heqësh dorë nga vetja,  
vetmia o duhet vrarë, o duhet pranuar.  
Jo. Ajo duhet vrarë duke hequr dorë nga vetja.

Ata mbetën gjashtë,  
ngaqë i pari hoqi dorë prej kohësh nga vetja.  
Mandej pesë, sepse edhe e gjashta,  
hoqi nga vetja dorë dhe dorën e saj  
e la mbi kokat e tyre,  
me idenë se ledhatimet janë pasuria e fukarallëkut.  
Ata, nga pesë, mbetën katër,  
duke u pakësuar bashkësia, si në problemat matematikore,  
hiqi kaq, pastaj zbriti kaq,  
tash dy janë në mend.  
Zbritja, pa disa tollovive ra ndjeshëm në tre,  
Ky është numër kritik.  
Imagjinojeni një javë me tri ditë,  
ç'mund të bësh me dy ditë pushimi dhe një pune,  
dy ditë dasmë e një vdekje?  
Bota do ishte çakërditur.

Në fund ata mbetëm dy,  
aq sa ishin në fillim.  
Në fakt dukeshin si dy,  
por nuk ishin asgjë.  
Kishin hequr dorë prej kohësh nga vetja,  
të hapërdarë nga pak nëpër botë,  
të dy e mendonin, asnjëri s'e thoshte.

*Shtator 2021*

Ç'TË BËJMË ME IKJEN KUR NA VJEN?



TASH VJEN IKJA  
(Një poezi në kundërkohë)

Tash vjen ikja  
ose më saktë koha për të ikur,  
jo andej nga erdhe,  
andej nga s'ke shkelur kurrë.  
Derisa të shpikësh një kundërkohë,  
duhet ta kesh ndalur kohën.  
Sa të gjesh një vend për të bujtur,  
duhet të lëvizësh,  
ngaqë të rrish,  
mund të humbasësh dhe ato që ke,  
jo më të gjesh diç që duhet.

Ja, vjen çasti për të ikur,  
dhe kur të ketë ikur ky çast  
ikur duhet të kesh bashkë me të.  
Duhet të kesh ardhur aty ku duhet.  
Duhet të kesh mbledhur një varg me “duhet”.  
Duhet me pasë,  
një sens, një masë,  
kujtimet thasë,  
të ardhmen dërrasë,  
të kalbur,  
me këmbën që shket mbi të,  
duke kërkuar ardhjen e çastit të ikjes.

Të ndalet ikja,  
duhet ndalur ardhja,  
bashkë me kohën lënë në shmang,  
më mirë duhet ndalur vetja,  
gjë që në u bëftë  
përherë bëhet keq.

*Gusht 2022*

## UDHËTIMI

Në udhëtime të gjata,  
rëndësi ka më shumë rruga sesa mbërritja,  
pamjet, përjetimet, vendimet,  
sidomos vendimet në udhëkryqe:  
se cilën rrugë duhet të zgjedhësh  
të shkosh më shpejt nga shtegu që s'njeh,  
apo të marrësh rrugën e gjatë të përhershme,  
thikë me dy presa,  
pra, rruga është pak a shumë  
zgjedhja e majës së thikës:  
këto vendosin për mbërritjen.

Jeta është udha më e shkurtër që bëjmë  
ngaqë shtigjet që zgjedhim janë të shkurtra,  
nuk i njohim,  
ama veç t'i shkelim duam,  
ato na shpien përherë te gabimi.  
Rinisja është si me thënë rizgjedhja e gabimit.  
Nga gabimi në gabim  
jeta jonë vjen e shkurtohet  
bëhet pasojë,  
brumë i ardhur shpejt.

Mbrëmja e mbrame mbërrin,  
me shtigjet e gabuara tërkuzë,  
ngatërruar sakaq në vrik.

A s'e sheh që udha më e shkurtër që bëjmë është jeta?  
Çdo udhë tjetër e marrë është segment,  
segment i ngushtë për te vdekja.

Mendoje si të duash!

## MA SHTIN SHAPTHIN KJO RRUGË

E paqetë kjo rrugë.

Makina, njerëz, pluhur, trotuar jo, ose shumë pak,  
dyqane, kafene, tek-tuk ndonjë pemë,  
pemë që dëshmojnë të ardhmen e zbërdhulët,  
por më së pakti njerëz,  
dhe ndonjëherë kazanë.

Po, po kazanë, që njerëzit hedhin mbeturina,  
që njerëzit e mbetur hedhin mbeturina,  
kazanë që na i ofron bashkia,  
bashkia që ofron thuajse vetëm kazanë,  
duke na kujtuar se jemi vetëm për të hedhur,  
ose për t'u hedhur,  
kudo qoftë, por më e mira do ishte  
të hidheshim në Amerikë,  
edhe në Kanada po të jetë s'prish punë,  
ne mjaftohemi me pak,  
sido, aty mbetet Gjermania.

Shumë e çuditshme kjo rrugë,  
me pleq plot,  
sa mund t'i vihej emri "Rruga e Pleqve",  
çdo rrugë e këtij vendi mund të quhej "Rruga e Pleqve".  
E shoh dhe herë më duket se ajo është rruga,  
herë më duket se rruga jam unë  
që duhet marrë me doemos,  
në mos sot, sot pasdite.  
Gjërat janë si t'i shohësh,  
dhe mua kjo rrugë më duket e frikshme.  
Sa herë i shoh kazanët më bëhet  
se dikush me doemos duhet hedhur.  
O unë duhem hedhur diku,  
o ky vend të hidhet në erë  
njëherë e përgjithmonë.

Shapthin ma shtin kjo rrugë,  
ose çdo rrugë,  
por sidomos kjo rrugë,  
ngaqë çdo brengë që nuk e shtie në shtëpi  
mbetet kësaj rruge,  
çdo hall që e lë jashtë zyrës së punës  
rëshqet te kjo rrugë.  
Shtëpia për pushim, zyra për punë.

Kështu e do përvoja.  
Sa dal në këtë rrugë brengat më ndjekin pas  
si policët vjedhësin e çantave.  
Të dal në këtë rrugë e të eci  
më bëhet të jem me të vërtetë vjedhës,  
vjedhësi i vetes sime  
duke ëndërruar për një rrugë,  
të bukur e të gjatë.  
Kur dal në këtë rrugë kam pak mundësi,  
o të shoh veç drejt e të mos i flas njeriu,  
o të shkruaj ndonjë poezi të gjatë,  
o të mendoj për ndonjë subjekt tregimi,  
o të jem patjetër me dikë,  
që t'iu them brengave që më ndjekin:  
Shikoni, jam kaq i zënë. Më vjen keq!

Është e paqartë kjo rrugë,  
me zhurma, me kazanë, e pleq,  
nga çasti në çast mund t'i ndodhë gjëma.  
Mund të mbetet pa mua,  
e të rrisë e vetme brengat e mia jetime.

*Korrik 2022*

## ÇFARË MENDOJNË PËR MUA?

Prindërit e mi mendojnë se jam i urtë,  
 ndërsa ime shoqe mendon se jam i mirë.  
 Motrat e mia mendojnë se jam i dashur,  
 dhe vëllezërit mendojnë se jam i zoti,  
 shokët mendojnë se jam i mbarë.  
 Në fisin tim mendojmë se jam i pasur.  
 Ata të *Instagram*-it mendojnë që jam i shëtitur,  
 ndërsa ata të *Facebook*-ut më dinë për shakaxhi.  
 Studentët mendojnë se jam njeri i zgjuar,  
 shefi im mendon se jam punëtor,  
 në Dibër më dinë për shkrimtar,  
 në Kosovë po ashtu.  
 Ndërsa në Tiranë nuk më njohin fare,  
 pak më pak në Durrës dhe më pak në Amerikë.  
 Por, po të më njihnin do mendoni se jam spanjoll,  
 jo se kam ndonjë shenjë, por doja të isha i tillë.  
 Të tjerë mendojnë se jam intelektual,  
 pakkush mendon se jam poet.  
 E di, të gjithë ia fusin kot.  
 Unë nuk jam asnjë nga këta.  
 Se çfarë jam as vetë s'e di.

Kur ta marr vesh do t'jua them.  
Deri atëherë, shijoni këtë poezi,  
dhe në ndërkohë mundohuni të jetoni.  
Veç mos më mbani inat,  
ose më mbani, por jo shumë,  
sidoqoftë, punë për ju.

*Korrik 2022*

## TË IKIM

Të ikim nga fshati, të ikim nga qyteti,  
të shmangemi nga tjetri, të ikim nga vedi,

të ikim nga shkolla, të ikim nga puna,  
të zhduket e diela, të shporret e shtuna,

të ikim nga toka, të ikim nga vendi,  
të dalim nga moda, të ikim nga trendi,

t'i ikim të shkuarës, të tashmen ta shmangim  
t'i ikim ndjenjës, mendimin ta lagim,

të ikim nga sendet, të ikim nga trajta  
nuk bën as e djathta, s'bën as e majta,

të ikim për ku? Të ikim kudo,  
se ikja për te ikja u bë domosdo,

veç edhe pse rrahim të ikim çdo çast,  
asaj që i ikim sall na ndjek përmbas.

## TË QËNDROSH DUKE IKUR

Një mënyrë e mirë për të qëndruar është të ikësh,  
në heshtje,  
aq butë, pa ta kuptuar as gjethet e pemëve,  
as zogjtë e harruar të vjeshtës,  
as pllakat e shtrembëta të trotuareve,  
as semaforët, këta gushëkuqët e qytetit,  
as kamerat e sigurive,  
as fatorinot nëpër urbane,  
as poezitë që presin të shkruhen  
në mënyrën më patetike të mundshme.  
Të ikësh nuk është aspak gjë e keqe,  
madje të ikësh sa më larg, më mirë,  
të ikësh sa më shpejt, më shpesh,  
mbrëmjes, natën, bash në mesin e natës.  
Të krijosh zbrazëtira sa të mundesh:  
kjo pra është punë guximi.

Mënyra më e mirë për të qëndruar  
është të ikësh.

Si fëmija që sapo nis të ecë,  
që të mos rrëzohesh duhet hedhur shpejt hapi tjetër,  
përpara me kokën në horizont,  
duke kërkuar pikëmbërritjen e radhës  
vendin e parë ku të lëshosh duart.  
Ikja mban ekuilibrat,  
do me thënë të mendosh për rrugën,  
ky është hapi galopant,  
si ecja me biçikletë,  
gungat duhen lënë në shmang për të ruajtur ekuilibrin.

Të ikësh është domosdoshmëri;  
ideja e të liruarit vend  
të bën të mendosh se ke bërë në mos gjënë e duhur,  
së paku gjënë e mirë,  
pikërisht,  
se bota gjithmonë do ta bëjë me gisht.

Të tentosh të ikësh pa u ndier,  
të tjerët do ta ndiejnë ikjen tënde  
kësisoj do bësh gjënë më të çmuar në jetë,  
t'u mbetesh në kujtesë,  
ashtu siç ishe herën e fundit,  
i buzëqeshur, si degëz blu zambaku.

Të ikësh pra,  
është çështje mbetjeje,  
sa më heshtshëm, sa më ngutshëm.

## KUR NISJA SOS

Kur nisja nis me rrokopujë,  
 kur sosja sos përpirë tahmah,  
 kur lidhen fijet me rrëmujë,  
 kur shkep e ngjitet kjo gjithkah,

kur teh i mendjes bie poshtë,  
 kur cep idesh më ngjiten nalt  
 nuk mundem më të gjej se çbosht,  
 trans-idetë m'i qet në baltë.

Çerek-idetë më lindin paq,  
 gjysmë-mendimet dalë shmang,  
 ku shkoi u tredh, u tret sakaq,  
 ky përjetim që shpirtin trand (?)

në kohë të largët, jashtëtokësore.  
 E tashmja rrudhur buzësh zbret,  
 idetë e plogëta, varg, për dore,  
 më shkyçen trupit gjithë siklet.

Disa më vijnë me *bold* në tru,  
disa më zbehtë në *italik*,  
disa të tjera bien në gjunjë,  
sakaq të shumtat turren vrik,

te botë e lashtë e tjetërkundit.  
Më bëhet vetja tjetër prore,  
idetë me *bold* i vë përfundi,  
me thikë në fyt si në thertore.

Dhe kaq pa bujë idetë e mia,  
të vdesin nisin pa u sosë,  
ndërkallë kështu te poezia,  
me ngut në taste janë vulosë.

Vulos me ngut në taste gerrat,  
tek sos nuk kanë pasi janë nisë,  
por jeta, vetja, hiset, bëmat,  
sakaq të gjitha janë bitisë.

*Shtator 2022*

## TEPRIA QË MUNGON

Jam tash ndryshore e vetes që humba  
kujtimesh që ngucin ngulmët si thumba

dhe puls i dhimbjes që veç më dëfton  
timpanin e shpirtit tek rëndë sëmbon.

Jam shumë larg asaj vetes që desha:  
shumë te pranvera, pjesëtim jam te vjeshta,

zhbërje te vera, minus jam në dimër,  
lypës i vetes, në më dhashtë Zoti ymër,

i rënë jam në çark, dorëzuar jam te kushtet,  
derdhja e kupës që kurrë s'po mbushet.

Jam, pra, tepria, që rëndomë na mungon,  
zbrazëtia pingule që përmbush çdo hon,

harresa e vetes që gjendet pasazheve,  
dyst i ndalesave, peng i mirazheve.

Jam çfarë nuk desha, jam çfarë s'arrita  
të bëhesha për ty, uji, fryma, drita.

Jam tash ndryshore e vetes që humba  
kujtimesh që palosa ngulmët si trumba.

Jam vetja që vetes s'i dhimbsem aspak  
për ty dhe për botën tretëm nga pak.

Veç, doja të thosha, ky jam pak a shumë:  
ajër në tokë dhe fluskë në shkumë.

*Tiranë, nëntor 2020*

## QYTETI I KRYQËZUAR NË “T”

Krejt jashtë më nxjerr ky qytet,  
si gruaja burrin që s’e do.  
As unë s’bëj dot ta dua,  
veç ta kundroj i përjashtuar  
si një vajzë që vështirë ta njohësh,  
por të cilës i kushton poezi lirike  
subjektivisht korrekte.  
Ta dua dot nuk mundem  
se referencat i kam të dobëta,  
lidhjet janë tëhollur:  
zhurma,  
makina,  
kafene,  
urbanë,  
dhe shtëpi të marra (sa më lirë) me qira,  
tek i kujton lagjeve kur shkel rastësisht:  
“këtë pallat e njoh”  
“aty kam jetuar dy vjet”  
“këtu kam kaluar aq kohë”  
gjendje që më dëftojnë sa i panjohur jam.